



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština - Assembly*

---

**LIGJI Nr. 04/L-066**

**PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objektivat**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

**Neni 2**

**Fushëveprimi dhe parimet e përgjithshme**

1. Administrimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit zhvillohet duke u bazuar në parimet e përgjithshme vijuese :

- 1.1. mbrojtja, ruajtja, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e karakteristikave tradicionale historike urbane të Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit bëhet sipas parametrave të elaboruar në nenet 5,6,7 dhe 8 në planin e konservimit, pjesë integrale e këtij ligji, Shtojca 1;
  - 1.2. integrimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit në të gjitha nivelet e planeve hapësinore e urbanistike zhvillimore të vendit;
  - 1.3. rehabilitimi, restaurimi, adaptimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave, monumenteve dhe mjediseve të tyre rrethuese në përputhje me standarde profesionale për konservim dhe restaurim;
  - 1.4. elaborimi i politikës dhe planit të menaxhimit të konservimit, me përcaktim të normave, detyrave dhe mënyrave të bashkëpunimit me autoritetet e trashëgimisë kulturore, autoritetet e planifikimit hapësinor dhe zhvillimor të vendit, autoritetet e qeverisjes komunale të Prizrenit dhe popullata;
  - 1.5. përcaktimi i të drejtave dhe obligimeve të poseduesve të pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje;
  - 1.6. pjesëmarrja në një proces transparent vendim marrjeje të palëve të ndryshme të interesit;
  - 1.7. sigurimi i fondeve sistematike për restaurim dhe mirëmbajtje të Qendrës historike të Prizrenit duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse të saj, përmes sigurimit të lehtësirave fiskale duke bërë stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit e kushteve të jetesës.
2. Konservimi dhe mbrojtja e Qendrës Historike të Prizrenit bëhet në pajtim me parimet dhe standardet ndërkombëtare në pajtim me Ligjin e trashëgimisë kulturore, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe dokumente ndërkombëtare të UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe traktatet e BE.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Qendra Historike e Prizrenit** – Zonë e mbrojtur e Qendrës Historike të Prizrenit të bazuar me këtë ligj.
- 1.2. **Këshilli Zbatues dhe Monitorues (KZM)** – Këshilli i përcaktuar sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039/2008.
- 1.3. **Komuna** – Komuna e Prizrenit.

1.4. **Zyra Komunale për Komunitete** – Zyra komunale e cila ka për qëllim përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe sigurimit të shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

1.5. **Kërkesa për projekt** - kërkesa për leje urbanistike për rekonstruim/rindërtim, restaurim, rehabilitim, revitalizim, ndërtim, rrënim, ndërhyrje në infrastrukturë ose modifikim të ndërtesave, ndërrim të destinimit të tyre, ndërmarrje të aktiviteteve të përkohshme ose të çfarëdo zhvillimeve tjera brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

1.6. **Drejtoria për Urbanizëm** – Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në komunën e Prizrenit, e cila është kompetente për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

1.7. **Këshilli** – Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit të themeluar me këtë ligj.

1.8. **Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit** – Instituti kompetent për mbrojtjen e Monumenteve në Prizren.

#### **Neni 4**

#### **Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit**

1. Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit me të gjitha elementet përbërëse të tij shtrihet në territorin me kufij të përcaktuar në hartë ku përfshihet territori i kalasë, plani i konservimit dhe lista e parcelave kadastrale, pjesë integrale e këtij ligji, shtojca 1.
2. Qendra e mbrojtur historike e Prizrenit, si pronë e trashëgimisë kulturore në mbrojtje përfshihet në listën e trashëgimisë kulturore, në mbrojtje të përhershme të Republikës së Kosovës.
3. Rivlerësimi apo rishikimi i Qendrës së mbrojtur historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj bëhet nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në bashkëpunim me institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore, me kërkesën apo propozimet e parashtruara nga persona fizik dhe juridik, si ne shtojcën 2 të këtij ligji me listën e monumenteve që gjenden në këtë shtojcë.

## **KREU II**

### **MEKANIZMAT E KONZERVITMIT**

#### **Neni 5**

1. Komuna e Prizrenit në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, harton, miraton dhe zbaton dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik që kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14, Ligjin nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003-14 dhe Ligjin për Trashëgiminë kulturore Nr. 02/L-88/2006.

2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Komuna respekton karakteristikat e Qendrës Historike të Prizrenit.

#### **Neni 6**

### **Aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara në Qendrën Historike të Prizrenit**

Për zbatimin e nenit 6 të këtij ligji, me qëllim të mbrojtjes së autencitetit dhe integritetit të Qendrës historike të Prizrenit, kufizohen dhe ndalohen aktivitetet si në vijim:

#### **1. Aktivitetet e kufizuara :**

1.1. bashkimi i dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme, përveç kur parcela është duke u kthyer në gjendjen e saj origjinale gjatë restaurimit, rindërtimit ose revitalizimit të ndërtesave tradicionale dhe monumentit që është nën mbrojtje;

1.2. vendosja e kiosqeve, tezgave, tavolinave dhe elementeve tjera montazhe, parkingjeve ose të ngjashme që do të pengonte vizurat dhe qasje të lirshme në monument si dhe vendosja e kontejnerëve dhe shportave tjera për mbeturina para dhe në afërsi të monumentit;

1.3. muzika me zë më të lartë se (shtatëdhjetë) 70 db, përveç gjatë ngjarjeve/organizimeve të natyrës publike, për të cilat merret paraprakisht leja prej Komunës;

1.4. vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m<sup>2</sup>) dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

## 2. Aktivitetet e ndaluara:

- 2.1. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale;
- 2.2. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë në objekte me lartësi më të madhe se Përdhese + dy (2) etazhe (P+2); apo lartësia e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror deri në nivel të vijës së strehës, tejkalon nëntë metra e gjysmë (9.5m); apo lartësia e tërësishme e të cilëve, e matur prej nivelit të terrenit natyror duke përfshirë çatinë dhe çfarëdo vazhdim tjetër fizik në objekt, tejkalon dymbëdhjetë metra e gjysmë (12.5m);
- 2.3. aktivitetet ndërtimore apo transformuese që do të rezultojnë me objekte ku sipërfaqja e përdhese tejkalon  $150\text{m}^2$ , me përjashtim të rasteve të veçanta të rindërtimit apo rifunksionalizimit të objekteve publike, duke e respektuar karakteristikat e Qendrës Historike, të cilat duhet të kalojnë po të njëjtat procedura të marrjes së lejes urbanistike nga Komuna dhe pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit;
- 2.4. aktivitetet që do të rezultojnë në ndryshimin permanent të morfologjisë natyrore të terrenit;
- 2.5. pompat e reja të derivateve të naftës si dhe ndërtimet industriale, fabrikat ose zhvillimet e ngjashme përfshirë eksploatimin e burimeve minerale dhe furrënaltat;
- 2.6. aktivitetet e natyrës komerciale të cilat përfshijnë një sipërfaqe të hapësirës së brendshme më të madhe se  $150\text{m}^2$  duke përfshirë depot, punëtoritë mekanike, supermarketet dhe klubet e natës;
- 2.7. funksionimi i kazinove, bastoreve dhe veprimtarive tjera të lojërave të fatit;

### **Neni 7 Zona e Kalasë**

Në Zonën e Kalasë, e cila është e definuar me parcelat kadastrale sipas Shtojces 1, janë të ndaluara të gjitha veprimtaritë ndërtimore dhe të infrastrukturës, përveç atyre që në mënyre të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konservimin, restaurimin, rekonstruimin/ rindërtimin dhe menaxhimin e kësaj zone.

## **Neni 8 Ndërhyrjet në infrastrukturë**

Çdo ndërhyrje në infrastrukturën e Qendrës Historike të Prizrenit, duke përfshirë: ujësjellësin, kanalizimin, rrjetin telefonik, rrjetin elektrik apo rrjetet tjera të infrastrukturës bëhen pas miratimit të Projektit zbatues nga Drejtoria për Urbanizëm dhe pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

## **Neni 9 Mbrojtja nga dëmtimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore**

1. Personi fizik dhe juridik, i cili bën ndërtimin, rrënimin, ndërhyrjet në infrastrukturë apo çfarëdo aktivitet tjetër, duhet të ndërmarrë paraprakisht të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur objektin e trashëgimisë kulturore dhe fetare nga shkaktimi i çfarëdo dëmi të mundshëm, gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve.
2. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të ndërmiren në koordinim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.
3. Personi fizik dhe juridik që bën ndërtimin, rrënimin, ndërhyrjet në infrastrukturë apo çfarëdo aktiviteti tjetër të ndaluar, paguan të gjitha shpenzimet e nevojshme për kthimin e objektit të dëmtuar të trashëgimisë kulturore dhe fetare në gjendjen para shkaktimit të dëmit.

## **Neni 10 Hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike**

Hulumtimet dhe Gërmimet Arkeologjike në Qendrën Historike të Prizrenit bëhen në pajtim me Ligjin për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88/2006.

## **Neni 11 Pastrimi dhe mbeturinat**

Me qëllim të ruajtjes së monumenteve dhe tërë Qendrës Historike të Prizrenit, Komuna harton Planin e menaxhimit të mbeturinave për këtë qendër në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

**Neni 12**  
**Lëvizja e automjeteve**

Organi kompetent komunal për rregullim të trafikut, harton planin dhe regjimin e posaçëm të transportit automobilistik për Qendrën Historike të Prizrenit me qëllim të sigurimit të lëvizjes së lehtë dhe të vazhdueshme, duke promovuar mjetet jo-motorike të transportit.

**Neni 13**  
**Masat e mbrojtjes ndaj zjarrit apo fatkeqësive natyrore**

1. Komuna harton planin për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit kundër zjarrit, rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.
2. Çdo lokacion, monument kulturor në pronë private apo publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës, në pajtim me ligjet në fuqi si dhe me doracakun e masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore dhe të zjarrit.

**KREU III**  
**KONSULTIMI DHE ZBATIMI**

**Neni 14**  
**Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit**

1. Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit duhet të themelohet nga Komuna e Prizrenit brenda (katër)4 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

1.1. gjashtë (6) anëtarë të shquar nga shoqëria civile e Kosovës që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe/ose promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit;

1.2. tre (3) anëtarë nga shoqëria civile sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni, do të përzgjidhen:

1.2.1. një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;

1.2.2. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe

1.2.3. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;

1.3. së paku dy (2) prej anëtarëve nga shoqëria civile do të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore, me kualifikim apo përvojë profesionale në fushë të tillë. Preferencë do të kenë kandidatët që i përmbushin të dy kriteret;

1.4. anëtari i shtatë do të jetë përfaqësues i Zyrës Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim.

2. Roli i Këshillit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore.

3. Këshilli përbëhet nga anëtarë me kualifikime të ndryshme profesionale dhe nga palë të ndryshme të interesit, siç janë organizatat rinore, shoqatat e biznesit, arkitektët, historianët, shoqatat kulturo-artistike.

4. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim duhet të konsultohet me komunitetet e ndryshme të cilat janë të lidhura historikisht me Qendrën Historike të Prizrenit, dhe të përfaqësojë mendimet e tyre në kuadër të Komitetit.

5. Anëtarët e Këshillit emërohen prej Kuvendit të Komunës për periudhë (tre)3 vjeçare, përmes procedurës e cila përfshin ftesë publike duke i përcaktuar kushtet për konkurrim dhe anëtarësim.

6. Asambleja Komunale emëron anëtarët e Këshillit të përzgjedhur nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe nga Kisha Ortodokse Serbe për këtë mandat.

7. Kryesuesi i Këshillit duhet të zgjidhet me votim të fshehtë nga shumica e anëtarëve të Këshillit.

8. Këshilli takohet së paku një herë në çdo tre muaj dhe publikon punën e tij me informatë publike dhe për këtë punë i raporton Kuvendit Komunal.

9. Kuorumi arrihet kur janë të pranishëm (pesë) 5 anëtarë të Këshillit.

10. Shkarkimi i anëtarit të Këshillit, bëhet nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Komunës ose me propozim të Kryesuesit të Komitetit, nëse tri herë radhazi pa arsye të vlefshme nuk ka marrë pjesë në mbledhje të Këshillit.

11. Në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit, emërohet anëtari i ri menjëherë pas identifikimit të kandidatit të kualifikuar në pajtim me këtë nen, por në asnjë rast jo më vonë se (nëntëdhjetë)90 ditë.

## **Neni 15**

### **Informimi publik lidhur me kërkesat për projekt**

1. Drejtoria për Urbanizëm përpilon në baza javore listën e kërkesave të pranura për projekte.



2. Lista nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të jetë publike dhe duhet t'u shpërndahet anëtarëve të Këshillit.

3. Dosja e plotë e kërkesave për projekte mirëmbahet dhe vihet në dispozicion për publikun nga Drejtoria për Urbanizëm.

## **Neni 16 Konsultimi**

1. Drejtoria për Urbanizëm, i dorëzon Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit dhe Kryesuesit të Këshillit për Trashëgimi Kulturorë një kopje të të gjitha kërkesave për projekte për leje urbanistike, ndërtimi, rrënimi apo ndryshimi të objekteve, për ndërrim të destinimit të tyre, zhvillim të aktiviteteve të përkohshme apo çfarëdo zhvillimi tjetër brenda Qendrës Historike të Prizrenit.

2. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, jep pëlqimin ose e refuzon kërkesën për projekt brenda (pesëmbëdhjetë) 15 ditësh.

3. Këshilli duhet të konsultohet me pronarin nëse prona e tij/saj preket nga kërkesa e projektit me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi për pronën.

4. Nëse dikush nga anëtarët e Këshillit ka ndonjë kundërshtim/vërejtje për një kërkesë për projekt, ai/a jo ka të drejtë të kërkojë konsultime shtesë.

5. Kërkesa nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë për Urbanizëm brenda (pesëmbëdhjetë) 15 ditëve, duke i dërguar kopje Kryesuesit të Këshillit.

6. Në qoftë se pas shtyrjes prej (pesëmbëdhjetë) 15 ditëve, në Drejtorinë për Urbanizëm nuk arrin asnjë kundërshtim ose kërkesë për konsultime shtesë, atëherë mund të procedohet me lëshimin e lejes.

## **Neni 17 Kërkesa për konsultime shtesë**

1. Në qoftë se një kërkesë për konsultime shtesë i dërgohet Drejtorisë për Urbanizëm, Kryesuesi i Këshillit thërret palët përkatëse (ku përfshihen anëtarët e Këshillit, Drejtoria për Urbanizëm, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit dhe palën që e parashtron kërkesën) për një takim me qëllim të adresimit të shqetësimeve dhe të negocimit të ndryshimeve të mundshme në projektin e parashtruar.

2. Nëse palët pajtohen me konsensus për ndryshime në projektin fillestar, versioni i plotë i kërkesës së ndryshuar i dorëzohet Këshillit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit për pajtimin e tyre formal para se të lëshohet leja.

### **Neni 18**

#### **E drejta në ankesë (Moratoriumi)**

1. Në qoftë se brenda (pesëmbëdhjetë) 15 ditëve pas kërkesës për konsultime shtesë nuk arrihet marrëveshja, Drejtoria e urbanizimit lëshon lejen përkatëse ose e refuzon duke u bazuar në Planin e konservimit dhe ligjet në fuqi.
2. Leja e lëshuar apo e refuzuar nga Drejtoria e urbanizimit, i dërgohet paraqitësit të kërkesës, Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Prizren dhe Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Prizrenit.
3. Kundër vendimit të Drejtorisë së urbanizimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të ushtrohet ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda (pesëmbëdhjetë) 15 dite nga dita e pranimin të vendimit për refuzim të lejes.
4. Vendimin sipas ankesës e merr MMPH në konsultim me Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sporteve dhe Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor.
5. Në përputhje me Ligjin për Zonat e veçanta të mbrojtura, kontestet që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe, do t'i referohen KZM-së përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sportit, Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe nëse është e nevojshme Gjykatës Kompetente.

### **Neni 19**

#### **Mbikëqyrja inspektuese**

1. Për zbatimin e këtij Ligji, organi komunal për inspektim në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, cakton inspektorë për mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe zhvillimeve në Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Inspektorët mbulojnë fushat e urbanizimit, ndërtimit, trashëgimisë kulturore dhe shërbimeve publike.

### **Neni 20**

#### **Masat ndëshkuese**

Gjobat e parapara me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim, dyfishohen në rast të shkeljeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit, ndërsa zbatohen masat sanksionuese të parapara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturor.

## **KREU IV ZHVILLIMI DHE PROMOVIMI**

### **Neni 21 Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit**

1. Komuna e Prizrenit, në kuadër të fushëveprimit të saj, themelon një Zyrë për Qendrën Historike të Prizrenit, me qëllim të:

1.1. koordinimit të veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare;

1.2. informimit të publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit.

1.3. promovimit dhe zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të pasur;

1.4. nxjerrjes dhe shpërndarjes së informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat.

2. Kërkesat për tubime publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit lejohen pas marrjes së pëlqimit nga Drejtoria për Shërbime Publike.

3. Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit punon në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët përkatëse të interesit, përfshirë Këshillin, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, Shoqatën e Biznesit, Zyrën Komunale për Komunitete, komunitetet fetare dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile.

## **KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE**

### **Neni 22 Mjetet financiare**

1. Komuna pranon mjete të nevojshme financiare për kompetencat shtesë lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare të kërkuara nga ky ligj.

2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni, përcaktohen në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-049/2008 për Financat e Pushtetit Lokal.

3. Komuna aplikon lehtësira fiskale për personat fizik dhe juridik brenda zonës së Qendrës Historike të Prizrenit, konform nenit 5 të Ligjit për Trashëgimin Kulturore.

**Neni 23**  
**Raporti me ligjet tjera**

1. Komuna dhe autoritetet përkatëse shtetërore sigurojnë që ligjet, rregulloret dhe planet hapësinore dhe urbanistike që aplikohen brenda Qendrës Historike të Prizrenit të jenë në përputhshmëri me dispozitat e këtij Ligji.

2. Asgjë në këtë Ligj nuk duhet të interpretohet si kufizim ose ndikim tjetër në të drejtat, privilegjet, statusin dhe imunitetet e dhëna nga Kushtetuta

**Neni 24**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-066**  
**20 Prill 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**


\_\_\_\_\_  
**Jakup KRASNIQI**



**LIGJI Nr. 04/L-066 PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT**

**SHTOJCAT**

**Qendra Historike e Prizrenit**



zona e Kalasë  
fortress area  
zona e Kaljaje



### **Parcelat kadastrale të cilat përfshihen në Qendrën Historike të Prizrenit:**

4883,3667,3671,3672,4882,3670,3669,3668,3662/2,3662/1,3660,3661,3656,7685/4,7685/3,3645,3654,3655,3657,3659,3634,3622,  
90416,3627,3632,3631,3635,3633,90411,3658,3636,3630,3628,3625,3623,3614,3624,3610,3613,3588,3587,3586,3584,3585,3589,  
3611,3612,3607,90321,3606,3604,3603,3602,3599,3600,3595,3596,3594,3593,3597,3593,3590,3591,3592,3583,3637,3638,3640,  
3639,3647,3646,3643,3642,3577,90324,3565,3566,3567,3569,3573,3574,3575,3576,3641,3644,3653,90456,3650,90322,3648,3226,  
3629,3582,3580,3581,4872,3579,3564,90437,3460,3459,3461,3462,3458,3458,3456,3455,3457,3454,3453,3464,3463,90350,3450,  
3451,3452,3449,90323,90414,3436,3438,3435/2,3435,3440,3441,3442,3431,3430,3429,3419/1,3419/2,3420/2,3421,3420/1,3422,  
3423,3424,3428,3427,3424,3426,3425,3400,3372,3373,3385,3387,90353,3388,90367,90370,3382,3381,3380,3374,3375,3376,3377,  
3378,4873,3379,3477,3476,3475,3474,3471,3473,3472,3470,3469,3468,3467,3466,4822,2385,2386,2387,2384,2383,2380,2379,2268,  
2269,2270,2271,2381,2260,2262,2261,2263,2265,2264,2267,2266,2258,2259,2255,2251,2252,2257,2256,2250,2249,2248,2247,2246,  
2254,2253,2235,2234,2236,2240,2238,2237,2241,2239,2242,2243,2244,2245,2388,2378,2377,2376,2375,2374,2371/1,2371/2,2373,  
2372,2370,2214,2216,2217,2215,2213,2212,2211,2218,2233,2232,2228,2229,2231,2230,2227,2225,2226,2224,2223,2222,2221,2220,  
2219,2202,2204,2201,2200,2199,2198,2205,2197/2,2207,2208,2209,2210,1437,1438/1,1438/2,1439,1440,1441,1444,1443,1442,1445  
,1447,1446,1449,1448,1450,1451,1453,1463,1454,1456,1455,1457,1458,1459,1462,1460,1461,2179,2180,2181,2182,2183,2184,2206  
,2185,2196/2,2197/1,2196/1,2195,2186,2187,2191,2190,2189,2188,2162,2161,2160,2164,2165,2163,2166,2168,2169,2170,2171,  
2172,2173,2175,2178,2177,2167,2157,2156,2158,2159,2161,2149,2150,2151,2152/4,2152/3,2152/2,2152/1,2153/6,2153/5,2153/4,  
2153/3,2153/2,2153/1,2154/2,2152/1,2155,1961,1962,1963,1964,1968,1969,1970,1971,1973,1976,1977,1978,1979,1980,1981,1999,  
2013,2014,2015,2016,2017,2019,90435,90343,2097,90452,2099,4812,2042,2041,2040,2039,2038,2023,2022,2021,2020,2087,2086,  
2088,2089,2098,2091,2092,2093,2096,2094,2095,2077,2076,2078,90403,90285,2084,2081,2083,2082,2085,3077,3076,3081,3078,  
3080,3079,3084,3083,3082,3085,3086,3244,3243,3242,3241,3240,3239,3237,3238,3089,3091,3090,3092,3096,3087,3088,3095,3094,  
3093,3234,3230,3235,3233,3103,3102,3101,3100,3097,3098,3099,3108,3109,4871,3106,3107,3105,3104,3110,3111,3112,3113,3114,  
3115,3116,3117,3228,3119,3120,3121,3136,3139,3140,3138,3141,3146,3145,3144,3143,3142,3137,3135,3134,3133,3132,3131,3147,  
3148,3149,3150,3152,3153,3154,3155,3156,3159,3158,3160,3166/1,3161,90331,3162,3163,3164,3165,3166,/2,3173,3174,3175,3176  
,3177,3178,3179,3180,3181,3182,3232,3231,3225,3224,3223,3219,3218,3220,3226,3222,3227,3221,3217,1663,1332,1330,1659,1944  
,1658,1668,1670,1667,1671,1676,1677,4833,1675,1669,1672,1673,1674,1942,1941,1942,1940,1939,1938,1685,1686,1687,1688,1684  
,1679,4833,1683,1681,1680,1937,1936,1934,1943,1917,1918,1932,1931,1930,1928/1,1928/2,1929,1928/3,1933,1927,1926,1925,



1924,4837,4833,1975,1983,1982,1986,1987,1988,1989,1990,1991,1992,1993,1994,1995,1996,1997,1998,1999,1975,1974,1967,1966,  
1972,1965,1698,1699,1702,1703,1701,1695,1694,1693,1692,90402,1689,1707,1708,1706,1710,1715,1711,1712,1705,1709,4838,  
1704,1700,1914,1912,1906,1913,1907,1908,1911,1910,1909,1903,1904,1905,2062,2063,2066,2067,2068/1,2068/2,4847,2074,2075,  
2072,2073,2071,2070,2069,2065,2064,2061,2060,2043,4846,2047/1,2047/2,2046/2,2046,2045,90287,2044,90289,2048,2049,2050,  
2051,2052,2053,2054,2059,2055,2058,2056,2057,2035,2034,2036,2033,2032,2037,2030,2031,90288,2029,2028,2027,2026,2024,  
2025,2272,2273,2274,2366,2369,2364,2363,2362,2361,2358,2360,2359,2276,2277,2283,2284,2285,2282,2281,2280,2279,2365,2275,  
2278,2357,2356,4850,2354,2353,2352,2351,2290,2287,2294,2355/1,2355/2,2291,2289,2288,2296,2297,2298,2295,2347,2346,2344,  
2299,2349,2286/1,2286/2,2350,2348,2345,2300,2301,2343,2342,2341,2340,2303,2304,2305,2309,2306,2307,2308,2302,2310,2311,  
2312,2314,2313,2319,2320,2323,2315,2318,2322,2316,2317,2324,2325,2335,2326,2328,2329,2321,2337,2336,2330,2338,2333,2331,  
2332,2134,2133,2132,2135,2136,2137,2138,2139,2005,2005/2,2006/3,2128,2127/2,2127/1,2148,2147,2146,2145,2004,2144,2005/5,  
2005/4,2005/3,2141,2142,2143,90365,90292,2005/1,2006/2,2118/1,2118/2,2117,2116,2114,2113,2007,2012,2008,2009,2010,2011,  
2112,2114,2113,90429,2103,1651,1652,1947,1948,1951,1952,1949,1950,90286,1960,1953,1946,1945,1657,1656,1653,1650,1654,  
1655,1954,1955,1956,1657,1958,1660,1665,1664, 3850, 3847, 3845, 3843, 3844, 3842, 3846, 3849, 3848, 3839, 3838, 3835, 3836,  
3837, 3833, 3832, 3828, 3827, 3830, 3829, 3831, 3827/2, 3827/1, 3730, 3731, 3729, 3733, 3732, 3734, 4881, 3695, 3696, 3697, 3722,  
3728, 3727, 90326, 3725, 3724, 3723, 3721, 3698, 3699, 3702, 3694, 3693, 3690, 3691, 3692, 4874, 3350, 3351, 3352, 3715, 3716,  
3717, 3841, 3840, 3842, 3717, 3718, 3719, 3720, 3700, 3701,3707, 3708, 3709, 3706, 3705, 3704, 3367, 3366, 3365, 3363, 3361,  
3360, 3362, 3357, 3356, 3359, 3358, 3355, 3354, 90371, 3714/2, 3620, 3619, 3618, 2621, 3713, 3711, 3714/3, 3714/1, 3703,3682,  
3683, 3681, 3710, 3712, 3685, 3684, 3703, 3687, 3665, 3692, 3689, 3688, 90318, 3686, 3368, 4884, 3735, 3736, 3737, 3749, 3750,  
3752, 3751, 3748, 3747, 3739, 3738, 3741, 3742, 3740, 3743, 3745, 3744, 3746, 3815, 3814, 3822, 3816, 3813, 3821, 90325, 3825,  
3826, 3820, 3819, 3818, 3817, 3809, 3808, 3810, 3911, 3802, 3805, 3807, 3806, 3801, 3804, 3803, 3679, 3678, 3677, 3676, 90319,  
3675, 3680, 3673, 3674, 3666, 3665, 3664,  
3663, 3667,2130,2126,2125,90293,2124,2123,2122,2121,3399,3398,3397,3396,3395,3394,3393,3392,3391,3390,3389,3388,4807/2  
,3443,3445,3446,3444,3448,3447,3418,3415,3417,3414,3416,3411,3413,3410,3412,3407,3409,3406,3408,3405,3403,3402,3404,  
90332,3172,3170,3171,3169,3168,3167,3183,3184,3186,3185,3130,3129,3128/1,3128/2,3127,3126,3122,3123,3228,3236,3229,4867,  
3297,3216,3215,3212,3211,3210,3208,3207,3209,3206,3205,3204,3203,3201,3202,3200,3199,3198,3214,3188,3187,3189,3190,3191,  
3192,3193,3213,3194,3195,3196,3197/1,3197/2,4864,3371,3369,3370,3306,3299,3298,3300,3301,3302,3303,3307,3296,3295,3294,  
3293,3290,3289,3288,3287,3286,3282,3283,3284,3285,3919,3918/1,3918/2,3917,3916,3915,3292,3291,3914,3291,3913,3912,3910,  
3305,3897,3898,3899,3901,3900,3902,3903,3904,3905,3906,3907,3908,3909,3924,3857,3855,3309,3316,3315,3314,3854,3853,3311,  
3312,3313,90418,3852,3851,3858,3860,3859,3870,3896,3895,3893,3894,3892,3889,3886,3867,3868,3862,3861,3863,3864,3873,387  
4,3871,3869,3872,3878,3888,3887,3879,3880,3881,3882,3883,3884,3865,3866,3338/1,3339,3340,3341,4870,3338/2,3337,3336,





3335,3333,3334,3332,3331,3330,3329,3328,3327,3326,3325,3324,3342,3343,3344,3345,3346,3347,3348,3349,3323,3322,3320,3321, 331,3319, 3248/1, 3247/0, 3246/0, 3248/2, 3249/0, 3250/0, 3245/0, 3255/0, 3254/0,3251/0, 3253/0, 3256/0, 3252/0, 3257/0, 3258/0, 3259/0, 3260/0, 3261/0, 3264/0, 3262/0, 3263/0,3265/0,3271/0, 3266/0, 3267/0, 3269/0, 3268/0, 3270/0, 3272/0, 3275/0, 3274/0,3273/0,3276/1,3276/2, ,2544/1,2544/1,2544/2, 2545/0,2547/0, 2546/0,2548/0,2553/0,2552/0,2554/0,2551/0, 2549/0, 2550/2, 2555/0, 2550/1,4781/0, 2558/0, 2559/0, 2556/0, 2561/0, 2542/0, 2543/2, 2557/0, 2562/0, 2569/0,2540/0, 2539/0, 2573/0, 2538/0, 2537/0, 2574/0, 2536/0, 2535/0, 2534/0, 2570/0, 2571/2, 2576/1, 90296/0, 2576/2, 2572/0,2571/1,2865/0, 2874/0, 2873/0, 2881/0, 2888/0, 2878/0, 2877/0, 2879/0, 2884/0, 2876/0, 2529/0, 2875/0, 2532/0, 2531/0, 2528/0, 2527/0, 2530/0, 2524/0,2526/0, 2525/0, 2523/0, 2522/0, 2521/0, 2520/0, 2519/0, 2885/0, 2370/0, 2516/0, 2517/0, 90406/0, 2368/0,1312/0, 1313/0,1314/0,1315/0, 1316/0, 1317/0,1318/0, 1319/0.

## **K A L A J A**

7685-1, 7675-2, 7675-4, 7675-3, 7675-1, 7676, 4840, 7683, 7684, 7688, 7681, 90460, 90243, 7678, 90442, 7674, 7677, 1902, 1901, 1900, 1899, 1898, 1897, 1896, 1895, 1894, 1889, 1890, 90291, 1892, 1888, 18889, 1890, 90290, 1886, 1885, 1887, 1884, 1883, 1882, 1881, 90361, 1880, 1879, 3434, 3435/1, 3433, 3432, 3435, 3435/2, 4880, 3568, 3570, 3572, 90413, 3561, 3560, 3557, 3559, 3558, 4877, 3537, 3538, 3544, 3545, 3546, 3554, 3553, 3552, 3550, 3551, 3549, 3548, 3547, 3543, 3539, 3542, 3541, 3500, 3501, 3504, 3503, 3502, 3500/2, 4878, 3506, 3516, 3518, 3520, 3519, 3515, 3517,3513, 3514, 3512, 3510, 3500, 3508, 3497/2, 90372, 90412, 3507, 3497/1, 3478, 3479, 3480, 3481, 3484, 3485, 3482, 3497/1, 3496, 3494, 3495, 3498, 3492, 3481, 3484, 3482, 3487, 3489, 3488, 3490, 3491, 3505, 3521, 3522, 3528, 3525, 3524, 3526, 90415, 3527, 3534, 3535, 3533, 3532, 3531, 3530, 3529, 90360.



## SHTOJCA II

### MONUMENTET KULTURORE NË QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENTIT

Nr.re	OBJEKTI	NR. VEND.	K O H A	V Ë R E J T J E
1.	Xhamia Maksut-pashës	502/68	1641	Në kompleksin e Marashit
2.	Xhamia Sofi Sinan-pashës	1599/48	1615	Në sheshin Shadërvan
3.	Xhamia Myderiz Ali Efendiut	411/89	1581	Pranë kishës katolike
4.	Xhamia Sejdi Beut		XVII	Te qendra zejtare
5.	Xhamia Gazi Mehmed Pashës	1442/57	1573/74	Kompleksi L.SH.P-ës
6.	Xhamia Emin Pashës	371/87	1831	
7.	minare xhamisë Jakub Evronos Zade (Arasta)	1300/70	1526	Minarja (Arasta xhamisë)
8.	Xhamia Haxhi Ramadanit		XVIII	
9.	Xhamia Kukli Mehmed beut	1299/70	1534/5	lagje saraqane
10.	Xhamia Iljaz Kuka	10383-29	1543	Lagjja Iljaz Kuka – rr. Hysein Rexhepi
11.	Xhamia Suziut	10299-9	1513	Kompleksi i Tabakhanes (Suziut) - rr. Rrasat e Kosharës



12.	Xhamia Mesxhid	10403-36	XX	Pranë kishës Levishka - rr. Salajdin Braha
<b>Nr.re</b>	<b>TEQET dhe TYRBET</b>	<b>NR. VEND.</b>	<b>K O H A</b>	<b>V Ë R E J T J E</b>
1.	Halveti teqe	1001/55	1699	lagje saraqane
2.	Teqe e Melamive		1858	Pranë sheshit të shadervanit
3.	Teqe e Sadive (Akhize baba)	502/68	1743	Në Marash
4.	Tyrbe e Mehmed Pashës	1442/57	1573	në oborrin e xhamisë
5.	Tyrbe Akhize -Babës	502/68	1747	Në Marash
<b>Nr.re</b>	<b>OBJEKTET E KISHËS ORTODOKSE SERBE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë të Levishës	352/48	1306/7	
2.	Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë	1589/48	XIV	Kompleksi Nënkalaja
3.	Shkolla Ortodokse për Priftërinj e Shën Kirilit dhe Metodit  (Shkolla e mesme orthodokse)	460/70	XIX	Pranë lumit Lumbardhi drejtimi shadërvan-marash
<b>Nr.re</b>	<b>KOMPLEKSI I REZIDENCËS EPISKOPIKE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Rezidenca e Peshkopit			Në kuadër të Kompleksit të Rezidencës Episkopike
2.	Katedralja e Shën Gjergjit	02-956/64	1887-903	Në kuadër të Kompleksit të Rezidencës Episkopike  Shadërvan



3.	Kisha e Shën Gjergjit (Runovic)	02-956/64	XV	Në kuadër të Kompleksit të Rezidencës Episkopike Shadërvan
4.	Kisha e Shën Nikollës (Tutic)	02-236/1/62	XIV	Në kuadër të Kompleksit të Rezidencës Episkopike Shadërvan
5.	Kisha e Shën Nikolla Rajkut	165/74	XIV	në oborrin e Sh.fill.Lidhja e Prizrenit
6.	(Ob. Ipeshkvisë) (Konzullata Ruse)	460/70	1970	(Në oborrin e kishës)
7.	Kisha Shën Damianit dhe Kuzmanit (magjistarit)	460/70	XIX	Kompleksi Nënkalaja
8.	Kisha e Shën Dielës	02-938/66	XIV	Kompleksi Nënkalaja
<b>Nr.re</b>	<b>MULLI DHE KROJE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Mulliri Shotmanit	502/68	XIX (XXI)	Në kompleksin e Marashit
2.	Mulliri Shehzades	502/68	XIX	Në kompleksin e Marashit
3.	Mullirri i Tabakhanes	10418-49	XVII	Kompleksi i Tabakhanes
4.	Topokli (gjasht çeshme)	502/68	XIX	Në kompleksin e Marashit
5.	Kroi Sinan pashës	385/77		Pranë xhamisë Sinan Pashës
6.	Kroi familjes Perolli		XIX	afër muzeut Arkeologjik
7.	Krojet në xhaminë e Gazi Mehmed pashës	1442/57	1573	Oborri i xhamisë GMP



8.	Tash çeshme	384/77	XIX	Në oborrin muz. Arkeologjik
9.	Kroi Binbashi	516/77	XIX	Renovuar 1902
10.	Kroi Kuvendit (Beledijes)	479/77	XX	
11.	Kroi Haxhi Ramadanit		XIX	Para xhamisë
12.	Kroi sheshit shadërvanit			Sheshi Shadërvan
13.	Kroi i Destan Kabashit	03-3868/77	XIX	Në oborrin e shtëpisë së Destan Kabashit
<b>Nr.re</b>	<b>NISHANET</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Nishani myderiz Ali efendisë	414/89	1621	në oborrin e xhamisë
2.	Nishani Emin Pashës	638/55	1839	në oborrin e xhamisë
3.	Nishanet në oborrin e xh. Iljaz Kuka	10383-29	XVI-XIX	Lagjja Iljaz Kuka – rr. Hysein Rexhepi
4.	Nishanet në oborrin e xh. së Suziut	10299-9	XVI-XX	Kompleksi i Tabakhanes (Suziut) - rr. Rrasat e Kosharës
5.	Nishanet e Suziut dhe Neharit	632/55	XVI-XX	Kompleksi i Tabakhanes (Suziut) - rr. Rrasat e Kosharës
6.	Nishanet në oborin e xhamisë së G. Mehmed Pashës	1442/57	XVII-XIX	Në oborrin e xhamisë
<b>Nr.re</b>	<b>OBJEKTET PUBLIKE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Hamami Gazi Mehmed pashës	380/54	1564	
2.	Hamami Shemsidin Beut (Muzeu Arheologjik)	1263/68	1498	



3.	Kompleksi Lidhjes shqiptare të Prizrenit	02-835 1967	1573-1580	Pranë xhamisë Gazi Mehmed pashës
4.	2 Trafostacionet e rrymës		XX	Pranë kishës katolike dhe pranë K Komunal
5.	Ura e gurit	2345/50	XVI	Rindërtruar 1982
6.	Kalaja e Prizrenit	1585/48	IV-V	
7.	Objekti (puntori) për përpunimin e lëkurës	10418-49	XVI-XX	Kompleksi i Tabakhanes
8.	Kuvendi i vjetër - Beledije	10415-10	XIX	Lagjja Tabakhana rr. Remzi Ademi
9.	Objekti i Arkivit Rajonal	10401-44A	1934	Mes kishës katolike dhe xh. Iljaz Kuka – rr. Hysein Rexhepi
10.	Objekti i ish muzeut të LNÇ-së	10401 -44B	1932	Mbrapa obj. të Beledijes - rr. Rrasat e Koshares
<b>Nr.re</b>	<b>OBJEKTET SAKRALE KATOLIKE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Konkatedrala Zonja Ndhëmtare		1870	Tërë kompleksi
<b>Nr.re</b>	<b>OBJEKTET E BANIMIT</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Familja Bilurdagi (Grazhdo)		XIX	Shtëpi
2.	Familja Koçbashliu		XIX	RR. Saraçve
3.	Familja Mijiq		XIX	Shtëpi Rr. G. Çavdarbashi
4.	Familja Grazhda	1100/55	XIX	Shtëpi



5.	Ymer Prizreni		XIX	Familja <u>Drini</u>
6.	Zija Beut (Burgive)		XIX	Shtëpi
7.	Familja Shpejti		XIX	Shtëpi
8.	Destan Kabashit		XIX	Shtëpi
9.	Ndëtsesa në Rr. G.Çavdarbashi	615/55	XVIII	Shtëpi Sheh Zades
10.	Mehmed Ali Xhelshynmedine		XIX	Shtëpi selamllëk
11.	Adem aga Xhonit		XIX	Shtëpi
12.	Familja Arapi		XIX	Shtëpi
13.	Familja Mullafazliu		XVIII	Shtëpi dhe Hani
14.	Familja Paqarizi		XIX	Shtëpi
15.	Familja Perolli		XIX	Shtëpi
16.	Sava Toskës		XIX	Shtëpi
17.	Familja Myftiu		1860	Shtëpi
18.	Sevime Dorambari	414/77	XIX	selamllëk
19.	Sylejman Dapko		XIX	Shtëpi



20.	Vehbi Haxhiu	414/77	XIX	selamllëk
21.	Ramiz Pashës		XIX	Shtëpi
22.	Shani Efendiut		XIX	Shtëpi
23.	Shtëpia Sheh Hasanit	1298/70	XVIII	Shtëpi
24.	Gani Dukagjinit	414/77	XIX	Shtëpi
25.	Familja Doda	414/77	1930	Shtëpi
26.	Familja Mashkulli	414/77	XIX	Shtëpi
27.	Fikret Mustafës		XIX	Shtëpi
28.	Shani efendiut		XIX	Selamllëk
29.	Ymer Qyse	502/68	1850	Shtëpi
30.	Bedridin Celina	502/68	XIX	Shtëpi
31.	Familja Llokvica	502/68	XIX	Shtëpi
32.	Izet Bajmaku	502/68	XIX	Shtëpi
33.	Shën Flori nr.1	460/70	XX	Shtëpi
34.	Shën Flori nr.1	460/70	XX	Shtëpi





35.	Musa Kantarxhiut	460/70	XX	Shtëpi
36.	Lokali Beni	460/70	XX	Lokal-Shadërvan
37.	Lokali Rada	460/70	XX	Lokal-Shadërvan
38.	Tom Kashnjeti	460/70	XIX	Shtëpi
39.	Lazër Lumezit nr. 5	460/70	1840	460/70
40.	Zef Dietarit	460/70	XIX	Rr.H.Rexhepi 110
41.	Tush Krasniqi	460/70	XIX	Shtëpi
42.	Shuaip Spahiut	957/64	1870	gërmadha
43.	Hilmi Hisarit		XIX	Shtëpi
44.	Shemsedin Kirajtani		XIX	Shtëpi
45.	Pushkatarve nr.16		XIX	Shtëpi
46.	Tun Karadagut	460/70	XIX	Shtëpi
47.	Hamzë Futko		XIX	Shtëpi
48.	Durmish Shero	460/70	XIX	Shtëpi
49.	Hasan Xhejlani	460/70	XIX	Shtëpi



50.	Jahir Hasanit	460/70	XX	ish Komiteti Krahinor
51.	Bajram Sokolit	414/77	XIX	Shtëpi-selamllëk
52.	Familja Bardho-selamllëk		XIX	Rr.Rrasat e Kosharës
53.	Shtëpia e fam. Kaqamaku	10369-43	XIX	Mes kishës katolike dhe xh. Iljaz Kuka – rr. Hysein Rexhepi
54.	Shtëpia e fam. Arënliu	10401-50A	XVII-XIX	Mbrapa obj. të Beledijes - rr. Rrasat e Koshares
55.	Shtëpia e Destan Kabashit 2	10401-44	1903/5	Afër kishës Levishka – rr. Salajdin Braha
<b>Nr.re</b>	<b>INSTITUCIONET ARSIMORE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Shkolla e mesme L. Antoni	460/70	XX	Lagje Nënkalaja
2.	Shk.fill. Lidhja e Prizrenit	460/70	XX	Pranë kishës katolike
3.	Shkolla mesme mjeksisë (tani gjimnazi)		XIX	Pranë kishës katolike
4.	Leximorja (biblioteka) e Suziut	10299-9	XVI	Kompleksi i Tabakhanes (Suziut) – rr. Rrasat e Koshares
<b>Nr.re</b>	<b>RARITETE NATYRORE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>
1.	Rapi i vjetër “platanus” në Marash		XVI	Në kompleksin Marash
<b>Nr.re</b>	<b>KOMPLEKSET ARKITEKTURALE</b>	<b>NR. VENDIMIT</b>	<b>KOHA</b>	<b>VËREJTJE</b>



1.	Mahalla e Marashit			
2.	Nënkalaja			
3.	Pantelia			
4.	Potokmahalla			

#### **Total 104 objekte dhe 4 komplekse arkitekturale**

Po ashtu në kuadër të zones së vjetër janë edhe komplekse të mbrojtura me ligj dhe që kanë vendim (para lufte). Ato janë: Kompleksi **Marash, Nënkalaja, Pantelia** dhe **Potokmahalla**. Në kuadër të këtyre komplekseve përfshihen të gjitha objekte mbrenda saj dhe ato kanë automatikisht vendimin nën mbrojtje.

#### Statusi i objektit nën mbrojtje

Edhe objektet e rralla ose objekte me vlerë të veçantë marrin statusin e objektit nën mbrojtje si psh. trupat ndriçuese nga shekulli XX, puntori të vjetra , kinema, etj. Andaj nuk mund të rrumbullaksohen me numra objekte me vlerë dhe se ato që nuk janë në listë nuk kanë vlerë. Nuk duhet haruar se procesi i vlersimit është në vazhdimësi dhe nuk është përfunduar.